

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                     |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | BE-ja i përgjigjet Kurtit dhe Ramës për vendimin e Hagës: Ajo jep drejtësi të paanshme - Euronews Albania                                                                                                                           |
| ADRESA  | <a href="https://euronews.al/be-ja-i-pergjigjet-kurtit-dhe-rames-per-vendimin-e-hages-ajo-jep-drejtësi-te-paanshme/">https://euronews.al/be-ja-i-pergjigjet-kurtit-dhe-rames-per-vendimin-e-hages-ajo-jep-drejtësi-te-paanshme/</a> |
| BURIMI  | euronews.al                                                                                                                                                                                                                         |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                              |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 18 shtator 2026, 15:36:22 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 15:31:06 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 64279ab0381abca5760fc8499a9998c063b66e3ea61581a880b045dacd45487e |
| TEKSTI     | 4a7939120e850fd0b7ca1c53ecc06417e864933d37ae4089006673c7bdd1e3a4 |
| PAMJA      | df5212065bb8d304fa017bcef091e20d22232348b0244479320f2287db03b627 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | c946f885ae072e2d8be6fe6573a0a22632666836f0181803e0d4959e425b4004                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 0f7613a812b8a42978251c1471689408cbc054af17ff19ea88699c02ceb99882                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c946f885ae072e2d8be6fe6573a0a22632666836f0181803e0d4959e425b4004>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



TREND

Gjyqi i UÇK Edi Rama Albin Kurti Rusia Kosova

KOSOVË | LAJM KRYESOR

## BE-ja i përgjigjet Kurtit dhe Ramës për vendimin e Hagës: Ajo jep drejtësi të paanshme

18 Shtator 2026 | 17:31

Bashkimi Evropian i është përgjigjur kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit, dhe kryeministrit të Shqipërisë, Edi Ramës, në lidhje me reagimet e tyre për dënimin ndaj drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku kreu i qeverisë së Kosovës e cilësoi vendimin si padrejtësi, ndërsa Rama si "marre".

Zëdhënësi i Komisionit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Christian Wigand, tha se Dhomat e Specializuara japin drejtësi duke zhvilluar procedura gjyqësore të drejta, të paanshme dhe të pavarura.

"Shikoni, ajo që mund të them për këtë çështje është se Bashkimi Evropian merr shënim aktgjykimin e shkallës së parë në çështjen e Prokurorisë së Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Dhomat e Specializuara të Kosovës japin drejtësi duke zhvilluar procedura gjyqësore të drejta, të paanshme dhe të pavarura, të bazuara në parimin e përgjegjësisë individuale penale. Personat e dënuar, natyrisht, kanë të drejtë të apelojnë aktgjykimin para gjyqtarëve të pavarur të apelit, në një trup gjykues të veçantë të shkallës së apelit. BE-ja u bën thirrje të gjitha palëve dhe aktorëve në Kosovë dhe në rajon që të tregojnë përmbytje", tha Wigand

Po ashtu, ai u shpreh se mbetet thelbësore të promovohet një mjedis i lirë nga frika dhe hakmarrjet si dhe të mbrohen viktimat dhe dëshmitarët.

Ndërsa, zëdhënësi i Komisionit Evropian për Zgjerim, Guillaume Mercier, iu referua fjalëve të Komisioneres Evropiane për Zgjerim, Marta Kos, duke thënë se aktgjykimet e Dhomave të Specializuara duhen të respektohen dhe se personat e dënuar kanë të drejtë t'i apelojnë ato aktgjykime.

"Dhomat e Specializuara të Kosovës janë një organ gjyqësor i paanshëm dhe i pavarur. Aktgjykimet e tyre duhen të respektohen dhe personat e dënuar kanë të drejtë të apelojnë. Kjo ka të bëjë me përgjegjësinë individuale dhe drejtësinë për viktimat dhe familjet e tyre nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Ne u bëjmë thirrje aktorëve në rajon që të ndihmojnë në shërimin e plagëve të së kaluarës. Vetëm përmes pajtimit vendet e rajonit mund t'i tejkalojnë ndarjet dhe të ecin përpara drejt një të ardhmeje të përbashkët, drejt Bashkimit Evropian", tha ai

### LAJMI I FUNDIT

17:21 Rusia paralajmëron Finlandën pas bashkimit me iniciativën bërthamore të Francës: Veprim i pamatur dhe i rrezikshëm

16:59 Princi Harry bën paraqitjen e parë publike pas kthimit në Britani: Bëra mirë që u riktheva në tokën britanike

16:49 Vladimir Putin voton online në zgjedhjet parlamentare në Rusi (VIDEO)

16:40 Jared Kushner iu drejtua Putinit në zyrë: Lëri këto kërcënime

SHPËRNDARJE  
ARTIKULLIN

16:35 Pentagoni publikon grupin e gjashtë të dosjeve për UFO-t

16:27 Rusia i kërkon Japonisë të tërheqë nga territori i saj sistemin raketor amerikan "Typhon"

TESTIM

Më 16 shtator, Gjykata Speciale ka marrë vendim të shkallës së parë që Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi të dënohen me nga 25 vjet burgim, Kadri Veseli me 18 dhe Rexhep Selimi me 13 vjet.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË | RAJONI

Kryeministri Kurti udhëton për në SHBA

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, sot ka udhëtuar për në New York të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku do të zhvillojë takime...

16:26 | 18/09/2026

KOSOVË | SPORT

Foda publikon listën e Kosovës për Ligën e Kombeve, tre prurje të reja

Përzgjedhësi i Kosovës, Franco Foda, ka publikuar listën e futbollistëve të ftuar për ndeshjet e radhës në Ligën e Kombeve. Në listën e përfaqësueses së...

14:50 | 18/09/2026

KOSOVË | SPORT

Valon Berisha dhe Fidan Aliti i japin fund aventurës me Kosovën

Valon Berisha dhe Fidan Aliti kanë njoftuar tërheqjen nga Kombëtarja e Kosovës, duke mbyllur një kapitull të rëndësishëm të karrierës së tyre. Berisha, i cili...

14:48 | 18/09/2026

TEMA

Vendi  
Rajoni  
Bota  
Video

SHËRBIME

Live  
Lajmi fundit  
Na ndiqni  
Euronews Radio  
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews  
Kushtet e përdorimit  
Politika e cookie  
Kontakttoni

Follow Euronews on all platforms: